- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigojë brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 623-23-9318-5-2-1/C529


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 25 muaj , nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe implantin gjer në kosoton e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar; (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është: 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësive të lejuara nga organi mbikëqyrës. Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 24 muaj
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.

Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te pergjithshme te kontrates. Menaxheri i Projektit do te percaktohet pas nenshkrimit te kontrates me vendim nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA)
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit eshte: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave te mbajtura eshte: 10 % te vleres se kontrates Kjo shume do te ndalet nga cdo pagesë e Kontraktuesit dhe do te paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklarates së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK. Kontraktuesi me kërkesë mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me Polisë të sigurimit apo dokument bankar i lëshuar nga ndonjë Kompani e Sigurimeve apo Bankë e Licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës, prej 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës me afat validiteti prej: 24 muaj, nga data e lëshimit të certifikatës për pranimit te përkohshëm te punimeve. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve: 24 muaj
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve eshte: 24 muaj . Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është: përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR RENOVIMIN E "KROIT TË DEMIRIT"					
Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.					
A.	PUNËT NDËRTIMORE				
1	PUNËT DEMOLIMIT				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Demolimi I derës së jashtme ekzistuese nga pvc. Largimin I mbeturinave inerte te behet ne vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	copë	1.00	200.00	200.00
1.2	Demolimi I dritarës ekzistuese nga pvc. Largimin I mbeturinave inerte te behet ne vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me	copë	1.00	200.00	200.00
1.4	Largimi I dheut për-rreth objektit, të krijohet hapësirë për levizje me distanc 1.5m dhe formësimi I skarpatës 1:5.	m³	31.00	80.00	2,480.00
1.5	Gërryerja dhe pastrimi i komplet sipërfaqes së jashtme të objektit.	m²	51.92	10.00	519.20
1.6	Demolimi, grryerja dhe pastrimi i murëve të brendshem të kroit	m²	40.00	10.00	400.00
1.7	Demolimi I kuzhinës ekzistuese. Largimin I mbeturinave inerte te behet ne vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	copë	1.00	100.00	100.00
1.8	Pas përfundimit të punimeve duhet të bëhet pastrimi i objektit si dhe terreni përreth objektit.	copë	1.00	100.00	100.00
TOTAL: 1					3,999.20
2	PUNËT E RENOVIMIT				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
Furnizimi dhe montimi i dritarës prej materialit të plastikës ngjyë e kafët me trashesi te profilit t=8.0cm me min. 5 komora (hapësira termike) dhe tre mbyllje gome.Plastika te jet e perforcuar me profil te çelikut (d=2mm) , adekuat per profilin e caktuar te PVC-se.Profili duhet të arrinë vlerat Uf prej 1.3 W/m2. Dritaret do të jenë me XHAM TE TREFISHT 4+16+4+16+4 mm, Ug=0,8 ë.m-2K-1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-34 dB.Mekanizmi për hapje jo më lartë se 175 cm. Të aplikohet sistem katërshtresor (Lowi) mbrojtës SIKKENS (apo të ngjajshme) me impregnim të thellë.					
2.1	Pos I me dimensione 140*160 cm	copë	1.00	300.00	300.00
Furnizimi dhe montimi derës te hyrja kryesore prej materialit të plastikës ngjyë e kafët me trashesi te profilit t=8.0cm profili i deres duhet të jete i rrafshët me xham ne mes me dismensione 30x160cm xhami duhet te jetë i kalitur. Me min. 5 komora (hapësira termike) dhe tre mbyllje gome.Plastika te jet e perforcuar me profil te çelikut (d=2mm) , adekuat per profilin e caktuar te PVC-se					
2.2	Pos A me dimensione 90*210 cm	copë	1.00	300.00	300.00
2.3	Furnizimi, transporti dhe punimi me stiroprit N4 i fasadës se jashtme. Me trashesi t=10 cm sipas projektit. Në çmim të llogaritet ngjitesa dhe elementet lidhese-tipllat.	m²	52.0	25.00	1,300.00
2.4	Furnizimi dhe vendosja e materialit termoizolues (styroodur) me trashesi t=8.0 cm e cila vendoset perreth xokulles se objektit,	m²	15.0	25.00	375.00
2.5	Furnizimi dhe ekzekutimi i fasadës në sipërfaqen e jashtme të objektit me ngjyre të bardhë demit (ne llogari te merret rrjetë, kënde, ngjitës, rabc,llaq i plastifikuar dhe ngjyra) në nuancë sipas përzgjedhjes së investitorit.	m²	67.0	25.00	1,675.00
2.6	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV në hapësirat e trotuareve dhe pjesën për rreth objektit, rreth kroit dhe në pjesen ballore të objektit, me trashesi 40 cm. Transporti deri në deponi, apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km.	m³	26.0	5.00	130.00
2.7	Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër vibruës me peshë 12t.	m²	50.0	5.00	250.00

2.8	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon. Fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur. Mbushja të realizohet në hapësirat ku do të ndërtohet trotuari dhe	m³	11.0	15.00	165.00
2.9	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit. material guror, fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=650kg/cm². Mbushja të realizohet në hapësirat ku do të ndërtohet trotuari dhe parkingjet.	m³	5.5	15.00	82.50
2.10	Furnizimi, transporti, dhe mveshja e dyshemesë, në pjesën hyrse të objektit trotuaret me gjërsi 1m për- rreth ojektit, dhe kroit me gurëve natyral të gdhendur me trashësi t=5-7cm. Në çmim të llogaritet llaqi nga cimentoja me trashësi 10cm se bashku me rrejt Q335 dhe punimi i fugave.	m²	50.0	30.00	1,500.00
2.11	Furnizimi, transporti, dhe mveshja e dyshemesë, murëve të brendshëm dhe pjesës së sipërme të kroit dhe rregullimi i shkallëve me gurëve natyral të gdhendur me trashësi t=2-3cm. Në çmim të llogaritet llaqi nga cimentoja dhe punimi i fugave.	m²	50.0	50.00	2,500.00
2.12	Furnizimi dhe montimi i skajoreve 8x20x80 cm në çmim të kalkulohet edhe betoni për shtangim nën skajor dhe mes fugave.	m'	80	15.00	1,200.00
2.13	Furnizimi, transporti dhe montimi ulëseve nga konstruksioni metalik dhe mbështetëse. Me profile metalike 6x2x180 cm me mbajtëse në të dy anë nga konstruksioni metalik. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid. Ulësja të punohet sipas detalit të prezantuar.	copë	6	100.00	600.00
2.14	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave për mbeturina në formë katrore nga metali me mbulesë metalike dhe shtyllë e cila inkastrohet në shputën e betonit 40x40x20 cm, me mekanizëm për Montim dhe çmontimin e shportës. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë të gjelbërt.	copë	3	40.00	120.00
2.15	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-Panja (Acer platanoides "Globosum"), me kurorë mirë të formuar, 200 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i çertifikuar. Mbillet në tetor-nëntor duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1 l, 5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk duhet të jenë të infektuar me	copë	15	25.00	375.00
2.16	Furnizimi, transporti dhe montimi i salabanakave, nga meremri me trashësi 2cm të pjesa e jashtme dhe të brendshme të dritarës. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja dhe selikoni.	m²	1	200.00	200.00
2.17	Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e murëve dhe plafonit në hapësiraat e brendshme të objektit, me bazë dhe ngjyrë të bardhë.	m²	87.0	5.00	435.00
2.18	Furnizimi, transporti dhe montimi i kuzhinës nga mediapani, pjesa e punës ku vendosen elementet me dimension 60x90cm të jetë nga material fundermax 11mm dhe punimi i lavamanit 60x45x30cm konstruksioni i kuzhinës të jetë antibakterial, dhe mekanizmat për hapje dhe mbyllje (Blum) montimi i elementve në pjesën e sipërme duhet të jenë me gjërsi 35cm dhe të vendosen deri në plafon. Në çmim të llogaritet edhe dekonti 20mm së bashku me ngjyrosjen të cilën vendoset në mes të dy elementeve	m'	4.5	250.00	1,125.00



2.19	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllave ndriqese metalike te plastifikuara me lartësi h=6m me bazament të betonit 80x80x80cm Karakteristikat teknike: Total power: 100 W Total luminous flux*: 200 lm/W CCT: 5700K IK Rating : IK10 IP Protection IP65 Battery Spec: 111-500WH Warrenty : 3 years Operating Temperature -20°C to +60°C Control: Motion sensor,PIR sensor	copë	2	350.00	700.00
TOTALI 2:					13,332.50
A.	REKAPITULLIM PUNËT NDËRTIMORE				
1	PUNËT DEMOLIMIT				3,999.2
2	PUNËT E RENOVIMIT				13,332.5
TOTALI -A- me TVSH					17,331.7
B	RREGULLIMI I SHTRATIT TË PËRROCKËS				
1	PUNËT PËRGATITORE				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë përrocka si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m'	120.00	1.00	120.00
1.2	Hulumtimi dhe pastrimi i terenit, rrënim i gërmadhave dhe mbeturinave, prerja e drunjëve, cungave të ndryshëm, shkurrave të vjetra si dhe pastrimi i lokacionit për ndërtimet e reja. Në çmim të kalkulohet pastrimi komplet trases ndërtuese me ngarkim dhe transporti deri në deponin më të afërt të caktuar nga organi mbikëqyrës (në të dy anët e përrockës).	m'	120.00	1.00	120.00
TOTALI POSICIONI:1					240.00
2	PUNËT E DHEUT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
2.1	Gërmimi i dheut (baltës) në fundin e përrockës dhe gërmimi i humusit në brigjet e përrockës. Në çmim të llogaritet transportimi deri në deponin e përcaktuar nga Organi mbikqyrës në largësi	m³	132.00	5.00	660.00
2.2	Gërmimi i dheut (kategoria III-IV) dhe materialeve tjera me makinë në vendpunim, në tërë sipërfaqen e profilave të rregulluar sipas projektit. Humusit i shëndosh duhet të ruhet, kurse materiali i panevojshëm të bartet deri në deponinë më të afërt, të caktuar nga organi mbikqyrës, gjithnjë sipas dispozitave udhëqëse të organit mbikqyrës.	m³	264.00	5.00	1,320.00
2.3	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e materialit mbushës gurorë jokoherent me CBR >20 %. Shtrirja dhe ngjeshja duhet të jetë në shtresa jo më të mëdha se 30 cm deri në modulën e ngjeshmërisë 50 KN/m2.	m³	231.00	1.00	231.00
2.4	Formimi i skarpave dhe i fundit të shtratit të përrockës sipas vizatimit me saktësi prej (+,-) 3 cm dhe gjuajtja e dheut dhe ngjeshja me mjetet e transportit.	m²	720.00	1.00	720.00
TOTALI POSICIONI:2					2,931.00



3	PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
3.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i pragut(kaskadës) hyrese nga betoni armuar me klase C-25/30. Në çmim te kalkulohet edhe armatura për shtangim dhe shtresa e rërës nën beton sipas detalit në projekt.	m³	7.80	100.00	780.00
3.2	Furnizimi, transporti dhe mvëshja shtratit të përroit, në pjesët pjerrëta(skarpatave) me gurë natyral, me dimensione të gurëve d=50cm, me trashësi t=30-50 cm. Mvëshja bëhet asisoji që gurët së pari përpunohen në dimensione të caktuara dhe pastaj vendosen me renditje sipas rregullave të parapara.	m³	180.00	50.00	9,000.00
TOTALI POSICIONI:3					9,780.00



4	PUNËT E LËSHESËS GYPORE				
Poz.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi Me Tvsh (€)	Vlera totale Me Tvsh (€)
4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave gypore me diametër Ø1000 mm nga betoni i armuar. Në këtë pozicion llogaritet edhe punimi i kokave hyrse dhe dalese nga beton-armea C25/30 duke e llogaritur edhe zhavorin 0-31.5mm për mbeshjtjelljen e lëshesës dhe mbushja deri në nivelin e konstruksionit të rrugës. Vërejtje: Lëshesat të montohen paralel 2 Copë me gjatësi L=7.0 m'.	m'	14.00	40.00	560.00
TOTALI POSICIONI:4					560.00
REKAPITULLIM RREGULLIMI I SHTRATIT TË PËRROCKËS					
B					
1	PUNËT PËRGATITORE				240.0
2	PUNËT E DIEUT				2,931.0
3	PUNIMI I SHTRATIT TË LUMIT				9,780.0
4	PUNËT E LËSHESËS GYPORE				560.0
TOTALI -B- me TVSH					13,511.0
REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM					
A	PUNËT NDËRTIMORE				17,331.70
B	RREGULLIMI I SHTRATIT TË PËRROCKËS				13,511.00
TOTALI ME TVSH:					30,842.70



PARAMASA DHE PARALLOGARIA "SHEPELLA E DOGAMIT"					
Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.					
A.	SHEPELLA E DAGONIT				
I	PUNËT NDËRTIMORE				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi ulëseve nga konstruksioni metalik dhe mbështetëse. Me profile metalike 6x2x180 cm me mbajtëse në të dy anët nga konstruksioni metalik, ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid. Ullësja të punohet sipas detalit të prezantuar. Në çmim të llogaritet edhe punimi i kubzave në vendin ku montohen ulset. 	copë	6	150.00 €	900.00 €
1.2	Furnizimi ,transporti dhe montimi i shportave per mbeturina ne formë katrore nga metali me mbulesë metalike dhe shtyllë e cila inkastrohet në shputën e betonit 40x40x20 cm, me mekanizëm për Montim dhe çmontimin e shportës. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë të gjelbërt.	copë	2	60.00 €	120.00 €
1.3	Furnizimi, transporti, gërmimi dhe montimi i shtyllave metalike ne cdo 2m distac me lartesi h=1.2m përgjatë shtratit të lumit Ne cmim te llogaritet edhe shputa e betonit C25/30 0.8x0.8, dhe thellesi 80cm.	copë	25	20.00 €	500.00 €
1.4	Furnizimi, transporti, dhe montimi rrethojës metalike Ø6 (sajrle) e cila vendoset ne menyre horizontale ne cdo 12cm rrethoja ankerohet ne shtylla metalike me vrima. Ne cmim te llogaritet ngjyrojsa me ngjyre anti korrozion.	m'	250	2.00 €	500.00 €
TOTAL ME TVSH: I					2,020.00 €



PARAMASA DHE PARALLOGARIA "TABELAT REKLAMUESE"					
Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e çertifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.					
A. TABELAT INFORMUESE					
1	PUNËT NDËRTIMORE				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi LEED Monitorit reklamuese me dimensione 80x140cm. me të gjitha paisjet përcjellëse me mundësi dirigjimi e reklamimi nga hapësira e brendshme e objektit(zyrës) LEED Monitorit duhet të ketë pamje nga të dy anët. Në çmim të llogaritet konstruksion metalik i cili shërben për mbajtjen e LEED Monitorit ku ankerohet në murin e jashtëm të objektit, dhe kyqja ne rrejtin elektrik.	copë	1	500.00 €	500.00 €
TOTAL ME TVSH: 1					500.00 €



PARAMASA DHE PARALLOGARIA "TABELAT INFORMUESE"					
Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.					
A. TABELAT INFORMUESE					
1	PUNËT NDËRTIMORE				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi tabelave informuese me shtyllë nga konstruksioni metalik i zinkuar me lartësi h=2.6m. 2m mbi nivelin e tokës me shputë nga B.A 80x80x60cm Tabela me dimensione: gjatësi 55cm pjesa nga informimi i tabelës duhet të jete ne formë trekëndeshe e cila orjenton destinacionin. lartësi 15 cm, tabela duhet të jetë flurushente reflektuese. Kompani është e obliguar qe secilën tabel të vendos në lokacionin të cilin e përcakton autoriteti kontraktues. Vërejtje shkrimet e tabelave realizohen sipas kërkesës nga autoriteti kontraktues.	copë	120	80.00 €	9,600.00 €
1.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i perdeve shiritore vertikale në të gjitha hapësirat e punës në zyrat e drejtorisë për zhvillim ekonomik . Materiali i perdeve duhet të jetë i trashë, i qëndrueshëm ndaj rrezeve UV dhe të pastrohet lehtë. Ngjyra dhe tekstura e perdeve shiritore vertikale të përcaktohet në koordinim me organin mbikqyrës.	m ²	15	25.00 €	375.00 €
1.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i klimes Invertet A+++, 18000 BTU. Njësia e jashtme të vendoset ne konstruksion metalik i cili ankerohet në murin e jashtëm. Në emim të llogaritit kyqja në rrjetin elektrik, dhe funksionalizimi i saj.	copë	1	800.00 €	800.00 €
1.4	Furnizimi, transporti dhe montimi folive reklamuese të cilat vendosen në dritare në pjesen e jashtme të xhamave në zyrat e drejtorisë për zhvillim ekonomik, folia duhet të jetë me ngjirës. Në emim të llogariten shkrimet dhe reklamat të cilat i përcakton autoriteti kontraktues.	m ²	12	30.00 €	360.00 €
TOTAL ME TVSH: 1					11,135.00 €



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA
NDËRTIMI I SHTEGUT TË ECJES NË ZOQISHTË**


Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyrë duhet të bëhet sigurimi i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve.

Punishtja të shenjëzohet dhe të vendosen tabela prej llamarine dhe me konstrukcion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheli edhe çkyqjen e instalimeve ekzistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

NDËRTIMI I SHITIGJEVE TË ECJES NË ZOQISHTË					
L=545.00 m					
1	PUNËT PREGADITORE				
Poz.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi Me Tvsh (€)	Vlera totale Me Tvsh (€)
1.1	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i repereve të rrjetes shtetërore për pjesën e shtegut sipas situacionit të dhënë. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i shtegut sipas profileve tërthore.	m'	545.00	7.00	3,815.00
1.2	Pastrimi i terenit nga objektet ekzistuese nga dy anët e shtegut si: prerja dhe largimi i drunjeve, shkurrave, lëshesave dhe materialeve tjera që e pengojnë ekzekutimin e trasesë. Në çmim të kalkulohet edhe bartja e tyre në një deponi ku e cakton organi përgjegjës i punishtes në largësi 10 km.	m'	545.00	8.00	4,360.00
1.3	Pastrimi i terenit dhe largimi i të gjitha materialeve të mbetura pas përfundimit të punimeve.	m'	545.00	1.00	545.00
TOTALI POSICIONI:1					8,720.00
2	PUNËT E GËRMIMIT				
Poz.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi Me Tvsh (€)	Vlera totale Me Tvsh (€)
2.1	Gërmimi i dheut të kategorisë III-VI dhe humusit. Në çmim duhet të parashihet edhe transporti i dheut deri në një vend ku e cakton organi mbikëqyrës dhe jo më pak se 10 km. Një pjesë e gërmimit duhet të përdoret për mbushje pas shqyrtimeve dhe me aprovim të organit mbikëqyrës.	m ³	791.34	5.00	3,956.70
2.2	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të shtegut për ceje me ngjeshmëri 30 MN/m ² .	m ²	1198.00	0.20	239.60
TOTALI POSICIONI:2					4,196.30
3	PUNËT E ZHAVORIT				
Poz.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi Me Tvsh (€)	Vlera totale Me Tvsh (€)
3.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63 mm, me trashësi t=20cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>60 Mpa.	m ³	223.45	21.00	4,692.45
3.2	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31.5 mm me trashësi t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >80MPa.	m ³	98.10	21.00	2,060.10
TOTALI POSICIONI:3					6,752.55



4	PUNËT TJERA				
Poz.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi Me Tvsh (€)	Vlera totale Me Tvsh (€)
4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave gypore me diametër Ø800 mm nga betoni i armuar. Në këtë pozicion llogaritet edhe punimi i kokave hyrse dhe dalese nga beton-armea C25/30 duke e llogaritur edhe zhavorin 0-31.5mm për mbeshjtjelljen e lëshesës dhe mbushja deri ne nivelin e konstruksionit të rrugës.	m'	25.00	20.00	500.00
4.2	Furnizimi, transporti dhe montimi ulëseve nga konstruksioni metalik dhe mbështetëse.Me profile metalike 6x2x180 cm me mbajtëse në të dy anët nga konstruksioni metalik, ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid. Uleshja të punohet sipas detalit të prezantuar. Në çmim të llogaritet edhe punimi i rruzoave ne vendin ku montohen ulset. 	copë	6	150.00 €	900.00 €
TOTALI POSICIONI:4					1,400.00
REKAPITULLIM NDËRTIMI I SHTIGJEVE NË ZOQISHTË L=545.0 m'					
Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT				SHUMA TOTALE
1	PUNËT PREGADITORE				8,720.00
2	PUNËT E GËRMIMIT				4,196.30
3	PUNËT E ZHAVORIT				6,752.55
4	PUNËT TJERA				1,400.00
TOTALI -A-					21,068.85 €



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA
NDËRTIMI I SHTEGUT TË ECJES NË ZATRIQ**

Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETAJET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

